Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Zyra e Drejtorit/ Kancelarija Direktora /Office of the Director

Numër: 02/385
Datë: 02.07.2018

Bazuar në nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20 pika 3 me nën-pikën 3.2, nenin 26, 50 pikat 1,2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe nenin 7 pika 2 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, kërkesës dt. 18.05.2018, si dhe në pamundësi të pranimit të stafit të rregullt, kryerjen e këtyre funksioneve në AKK, Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) nxjerrë:

VENDIM

1. Marrëveshje për shërbime të veçanta të z. Arianit Fazliut në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, si ekspert i Teknologjisë Informative (IT), me qëllim të mirëmbajtjes, publikimit dhe të përditësimit të të dhënave në web-faqen e AKK-së.

2. Përgjegjësitë dhe detyrat e z. Fazliu gjatë periudhës së shërbimit në AKK:

   - Mirëmbajtja i linkut www.akk-ks.net, domein dhe hosting.
   - Publikimi i materialeve në tri gjuhë zyrtare të dërguara nga AKK sipas nevojës (24/7).
   - Publikimi i foto dhe video galerive.
   - Konvertimi i dokumenteve në PDF dhe publikimi i tyre online ne WEB faqe dhe rrjete sociale (facebook).
   - Trajnime për WEB për stafin e AKK sipa nevojës.
   - Kompaktibiliteti i WEB me broëser të ndryshëm, angazhimi në mirëmbajtje të kodit duke ruajtur këtë funksion.
   - Të bëjë arkivimin e databazës dhe fajllave fizik në baza mujore.
   - Ndryshimi i vegëzave dhe linqeve sipas nevojës

3. Për përmbushjen e përgjegjësive të përshkruara më lartë, angazhimi i z. Fazliu do të jetë për një periudhë 3 mujore, ndërsa kompensimi i punës (pagesa) do të bëhet në lartësi prej, 423.47 euro në muaj.
4. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Arsyetim

Duke marrë parasysh se, Ligji për Kualifikime Kombëtare nr. 03/L-060, e obligon Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve të hartoj, rregullojë dhe menaxhojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në zbatim të Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike, nr. 03/L-125, me qëllim të realizimit të detyrave dhe në dobi të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe institucioneve vendore e ndërkombëtare si dhe grupeve tjera të interesit, në të mirë të rritjes së transparencës dhe efikasitetit e vlerësojmë të domosdoshëm angazhimin e një zyrtari të IT, në AKK.

Vendimi u dërgohet:

1. Të emëruarit;
2. Divizionit të personelit;
3. Zyrës së Drejtorit të AKK;
4. Arkivit tw AKK.

Lah Nitaj
Drejtor i AKK